



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE**

Nr.....Prot.

Vlorë më, 19.10.2018

**Lënda: Njoftim punësimi**

**Drejtuar: Z. Altin Mahilaj**  
Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Teknologjike dhe Zhvillimit

Bazuar në Urdhërin Nr.83, datë 19.10.2018 të Rektorit, ju lutem të shpallni njoftimin zyrtar për konkurim të hapur, për vendin e lirë të punës në web-in e Universitetit, sipas njoftimit bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**DREJTOR**

**Eloina Tozaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE**  
**NJOFTIM**

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, bazuar në Urdhërin Nr.83, datë 19.10.2018 të Rektorit, *shpall* njoftimin për konkurim të hapur, për vendin e lirë të punës në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë:

**1. DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË**

Fakulteti i Shkencave Teknike kërkon të rekrutojë në Departamentin e Biologjisë **1 (një) pedagog me kohë të pjesshme:**

*Përshkrimi i vendit të punës:*

- Pedagog (Kategoria Asistent-lektorë) me angazhimin me kohë të pjesshme.
- Mësimdhënie në veprimtaritë akademike

*Të interesuarit për vendet e mësipërme duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:*

**Kriteret bazë**

1. Të jetë diplomuar në sistemin me kohë të plotë dhe të zotërojë të paktën diplomën "Master i Shkencave" në Biologji ose ekuivalente me të në fushën përkatëse, të fituara në IAL në Shqipëri, në universitetet perëndimore ose universitete të huaja të njohura për nivelin e tyre.
2. Nota mesatare për çdo diplomë të ciklit të parë dhe të dytë ose ekuivalente me ato, duhet të jetë të paktën 8.5 (tetë e pesë të dhjeta)

**II. Kriteret preferenciale** të përzgjedhjes së kandidatëve për personel akademik, të renditura sipas preferencës si me poshtë:

1. Kandidatët që kanë fituar gradën shkencore "PhD" në universitetet perëndimore apo universitete të huaja të njohura për nivelin e tyre (në fushën e kërkuar).
2. Kandidatët të cilët kane fituar gradën "Doktor i Shkencave" në IAL në Shqipëri (në fushën e kërkuar).
3. Kandidatët që ndjekin studimet e ciklit të tretë të Doktoratës.

**III. Kriteret tjera**

1. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të jenë të motivuar për të punuar në grup.
2. Të jenë të aftë të garantojnë standartin e cilësisë dhe efikasitetin në punë.
3. Të plotësojnë kriteret e punësimit të përcaktuar në statutin dhe rregulloren e UV:
  - Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurron;
  - Të ketë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit profesional me kolegët dhe studentët;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË




## UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE

- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një krimi;
  - Të mos jetë marrë ndaj tij masë disiplinore e largimit nga puna apo zgjidhjes së kontratës nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë;
  - Të mos ketë vepruar ose propaganduar në drejtim të prishjes së imazhit të universitetit dhe autoriteteve drejtuese, në median vizive dhe/apo të shkruar, rrjetet sociale etj.
4. Kandidati nuk duhet të ketë patur background negativ apo performancë jo të mirë qoftë edhe në një rast të vetëm të eksperiencës në punë, të mos jenë në proces gjyqësor me UV-në.
5. Për kandidatët e diplomuar në universitetet perëndimore dhe universitetet e huaja të njohura për nivelin e tyre, do të bëhet konvertimi i notës mesatare sipas sistemit tonë të vlerësimit dhe përcaktimi i koeficientit të ponderimit të saj për efekt të kriterit bazë të përzgjedhjes. Koeficienti i ponderimit do të përcaktohet në varësi të nivelit të universitetit dhe të fushës së studimit.

### IV. Vlerësimi me pikë do të bëhet duke u referuar tek:

- Rezultatet e shkollimit për çdo diplomë
- Eksperienca në mësimdhënie në IAL në Shqipëri:
- Botime
- Referime:
- Kurse kualifikimi
- Njohuri të gjuhëve perëndimore
- Studimet e ciklit të tretë të doktoratës në vijim
- Faza e dytë: Intervista

### DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- a. Dokumentat duhet të dorëzohen **vetëm nëpërmjet shërbimit postar** në adresën: 

**Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë,  
Lagjja. "Pavarësia", Rr. "Kosova"  
9400 Vlorë, Shqipëri  
Drejtoria e Komunikimit dhe e  
Burimeve Njerëzore  
Pozicioni përse aplikohet**

- b. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:
- Formularin e aplikimit i cili mund të shkarkohet në faqen e internetit të universitetit në adresën [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al),
  - Fotokopje të kartës së identitetit ID;
  - Jetëshkrim/ C.V;
  - Kopje të noterizuar të Diplomës/ave universitare
  - Lista e notave e studimeve universitare duhet të jetë origjinale



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE

- Kopje të noterizuar të gradës shkencore dhe titujve akademik.
- Kopje të noterizuar të librezës së punës;
- Raport mjekësor (origjinal) për aftësinë në punë, lëshuar 3 muajt e fundit.
- Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore.
- Dëshmi të noterizuara të kualifikimeve, trajnimeve, arsimim shtesë, apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj
- Kopje të artikujve, teksteve, revista, projekte shkencore etj.
- Dëshmi të pjesëmarrjes në konferenca apo seminare, *workshop-e* etj te cilat duhen te jene fotokopje e noterizuar
- Deklaratë e kandidatit për mos pasjen e konfliktit të interesit dhe nepotizëm me personelin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

*Diplomat, çertifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, të shoqërohen me çertifikatën e njehsimit e noterizuar, bazuar në nenin 92 të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" të cilat duhet të jenë të noterizuar.*

- c. Afati që u lihet kandidatëve për të aplikuar është **2 javë kalendarike (19 tetor – 02 Nëntor )** nga dita e publikimit të njoftimit në faqen zyrtare të internetit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- d. Konkurimi do të kalojë në dy faza, me vlerësim dosjeje dhe me intervistë të drejtpërdrejtë.
  - ✓ **Nuk lejohet dorëzimi i dokumentacionit dorazi.**
  - ✓ Kandidati që paraqet mangësi në dokumentacionin e dorëzuar nuk do të merret në konsideratë nga Komisioni *ad hoc*.
  - ✓ Kandidati i cili kalon fazën e parë të vlerësimit të dosjes por që nuk paraqitet në fazën e dytë, të intervistës me gojë, skualifikohet nga konkurimi.
  - ✓ Afati që u lihet kandidatëve për të aplikuar është 2 javë kalendarike nga dita e publikimit të njoftimit në faqen zyrtare të internetit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
  - ✓ Afati i fundit i dorezimit te zarfave eshte data **02.11.2018.**
  - ✓ **ZARFAT E ARDHUR PAS KËTIJ AFATI NUK DO T'I KALOHEIN KOMISIONIT PËR VLERËSIM.**